

## PROCESVERBAL

### I

## MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË GJYKATËS SË LARTË

Tiranë, me 19.06.2026

Me datë 19.06.2026, me kërkesën dhe nën drejtimin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë, e cila i ishte njoftuar 3 ditë para anëtarëve të Këshillit së bashku me materialet përkatëse, kishte në rend dite çështjet si vijon:

- 1. Dhënia e statusit të nëpunësit civil gjyqësor për 2 (dy) specialistë, sektori i sigurisë dhe ruajtjes së rendit, Drejtoria e IT dhe Sigurisë;*
- 2. Miratimi i rregullave të veçanta për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në Gjykatën e Lartë;*
- 3. Të ndryshme.*

Këshilli i Gjykatës përbëhej nga anëtarët si vijon:

1. Z. Sokol SADUSHI – Kryetar i Gjykatës së Lartë
1. Z. Ilir PANDA – Zv/Kryetar i Gjykatës së Lartë
2. Z. Kelment GRECA – Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Të pranishëm në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës ishin edhe:

- 1) A. V. - Drejtore e Kabinetit të Kryetarit
- 2) A. K. - Kancelare në detyrë
- 3) M. K. - Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit
- 4) E. D. - Sekretare gjyqësore
- 5) A. A. – Specialist IT në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë

Në fjalën hyrëse, Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, pasi konstatoi prezencën e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit, deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit, me rendin përkatës të ditës, i cili u miratua, dhe vijoi me rendin e ditës.

Lidhur me **pikën e parë të rendit të ditës**, që kishte të bënte me dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor për 2 (dy) specialist të Sektorit të Sigurisë pranë Drejtoria së Sigurisë dhe IT, Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, ia dha fjalën Kancelares në detyrë A. K., e cila paraqiti vlerësimet e rezultateve të punës që i janë bërë specialistëve G. D dhe S. M., së bashku me mendimin pozitiv për konfirmimin e tyre në detyrë si nëpunës civilë gjyqësorë. Bazuar në vlerësimet e kryera, Këshilli i Gjykatës vendosi unanimisht konfirmimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqësorë G. D dhe S. M. në pozicionin “specialist” në Sektorin e Sigurisë, pranë Drejtoria së Sigurisë dhe IT.

Lidhur me **pikën e dytë të rendit të ditës**, që kishte të bënte me miratimin e rregullave të veçanta për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në Gjykatën e Lartë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi sqaroi se është përgatitur një projekt vendim për miratimin e rregullave të veçanta për ruajtjen e sigurisë në Gjykatën e Lartë dhe kërkoi opinionin e anëtarëve të Këshillit.

Anëtari i Këshillit të Gjykatës z. Ilir Panda, u shpreh në parim dakort me projektvendimin, duke parashtruar gjithashtu edhe disa sugjerime që ai kishte paraqitur dhe diskutuar paraprakisht me Kancelaren e Gjykatës.

Anëtari i Këshillit të Gjykatës, z. Klement Greca shprehu dakortësinë me projektvendimin, duke evidentuar se ekspertët e Këshillit të Europës që bënë një auditim në Gjykatën e Lartë e kanë nxjerrë këtë Gjykatë pa risk dhe me një nivel shumë të mirë të sigurisë dhe ky vendim do të forcojë dhe më shumë rregullin dhe sigurinë në Gjykatën e Lartë.

Anëtarët e Këshillit të Gjykatës miratuan unanimisht projektvendimi sipas variantit të paraqitur si dhe me sugjerimet e paraqitura nga anëtari i Këshillit të Gjykatës z. Ilir Panda.

Lidhur me **pikën e fundit të rendit të ditës “të ndryshme”**, e cila kishte të bënte me ndërprerjen e marrëdhënieve me shërbimin civil gjyqësor të specialistes E. S., për shkak të dorëheqjes nga detyra, Këshilli i Gjykatës unanimisht vendosi për ndërprerjen e marrëdhënieve me shërbimit civil gjyqësor të punonjësës E. S.